



**Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh
të Universitetit Politeknik të Tiranës,
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus +
në Universitetin e Poitiers, Francë.**

Në kuadër të programit Erasmus + dhe Marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i Prodhim Menaxhimit, në Universitetin e Poitiers, Francë.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

Shkëmbimin e studentëve të nivelit Master i Shkencave për studime.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

Master i shkencave - Studentët duhet të jenë të regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave, "Inxhinieri Mekanike" dhe "Inxhinieri Ekonomike", në vitin e parë ose të dytë, në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike.

Kohëzgjatja e bursave dhe numri total i studentëve:

Master i shkencave, një periudhë 1 vjeçare, Shtator 2021–Shtator 2022,
4 studentë.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Master shkencor:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Listë notash të studimeve Bachelor për studentët Master viti i parë dhe Listë notash të studimeve Master për studentët Master viti i dytë;
- Aplikuesit duhet të kenë mesatare të studimeve mbi 7.0.
- Letër Motivimi;
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*.

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën franceze ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar për gjuhën, duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj përpara afatit të nisjes (Shtator 2021) .*

Afati për aplikim për studentët: deri më 26 Mars 2021



Aplikimi kryhet pranë Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.

Të interesuarit mund të drejtohen pranë Departamentit të Prodhim Menaxhimit, për të dorëzuar dokumentacionin përkatës. (Kontakti Dr. Ilo Bodi, email: ibodi@fim.edu.al)

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit mund të kontaktoni në email: zyraekarrieres@upt.al